



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 153

Tiranë – E Martë, 7 Tetor 2014

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 116/2014 datë 11.9.2014	Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë .....	7955
Ligj nr. 117/2014 datë 11.9.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Erasmus +”, Programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin .....	7961
Ligj nr. 118/2014 datë 11.9.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin dhe statutin e Organizatës Europiane të së Drejtës Publike .....	7965
Vendim i Kuvendit nr. 71/2014 datë 2.10.2014	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 64/2013 “Për fillimin e procedurave parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të KLSH-së” .....	7970
Vendim i Kuvendit nr. 72/2014 datë 2.10.2014	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar ...	7970



**LIGJ**  
**Nr. 116/2014**

**PËR AKREDITIMIN E ORGANEVE TË  
VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj përcakton rregulla për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet në çdo rast akreditimi, pavarësisht nëse organi i vlerësimit të konformitetit kryen aktivitet të vlerësimit të konformitetit në fushën vullnetare apo të detyrueshme dhe pavarësisht nëse vlerësimi është i detyrueshëm apo vullnetar.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e

harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

2. “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organizmi i vetëm që kryen akreditimin me autoritetin e dhënë nga ligji.

3. “Certifikatë akreditimi” është një dokument ose një tërësi dokumentesh zyrtare, që deklarojnë akreditimin për një fushë të përcaktuar.

4. “Simbol i akreditimit” është simboli i miratuar nga organizmi kombëtar i akreditimit, i cili përdoret nga organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara për të treguar statusin e akreditimit të tyre, sipas rregullave të vendosura nga organizmi kombëtar i akreditimit.

5. “Vlerësim konformiteti” është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuar për një produkt, proces, shërbim, sistem, person ose organ.

6. “Organ i vlerësimit të konformitetit” është çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

7. “Mbikëqyrje” është tërësia e veprimtarive, me përjashtim të rivlerësimit, për të kontrolluar plotësimin e vazhdueshëm të kërkesave të akreditimit nga organi i vlerësimit të konformitetit, i akredituar.

8. “Reduktim i akreditimit” është procesi i tërheqjes së akreditimit për një pjesë të fushës së tij.

9. “Pezullim i akreditimit” është procesi i deklarimit të pavlefshmërisë së përkohshme të akreditimit për një pjesë ose për të gjithë fushën e tij.

10. “Tërheqje e akreditimit” është procesi i ndalimit të vlefshmërisë së akreditimit për të gjithë fushën e tij.

11. “Zgjerim i akreditimit” është procesi i shtimit të numrit të shërbimeve të akredituara ose të fushës së akreditimit.

12. “Apelim” është kërkesa e një organi të vlerësimit të konformitetit drejtuar organizmit kombëtar të akreditimit për rishikimin e vendimit për akreditimin e tij, të pafavorshëm për të, të marrë nga ky organizëm.

13. “Ankesë” është shprehja e pakënaqësisë, e ndryshme nga apelimi, nga një person ose

<sup>1</sup> Ky ligj është përafërur pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 765/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008, “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut në lidhje me tregtimin e produkteve dhe shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 339/93”, Numri CELEX: 32008R0765, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. L 218, datë 13.8.2008, faqe 30-47.



organizatë, tek organizmi kombëtar i akreditimit për veprimtaritë e këtij organizmi apo të organit të vlerësimit të konformitetit, të akredituar, për të cilën pritet një përgjigje.

14. “Konsulencë” është pjesëmarrja në një nga aktivitetet e organeve të vlerësimit të konformitetit që janë objekt i akreditimit.

15. “Vlerësim i ndërsjellë” është procesi i vlerësimit të një organizmi kombëtar të akreditimit nga organizma të tjerë kombëtarë të akreditimit, që kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe, sipas rastit, edhe me specifikimet teknike sektoriale.

16. “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e tregtisë.

## KREU II ORGANIZIMI

### Neni 4 Parime të përgjithshme

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është institucion buxhetor që varet nga ministria përgjegjëse për çështjet e tregtisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kryen veprimtarinë e saj mbi baza jofitimprurëse.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk kryen aktivitete ose shërbime që kryhen nga organet e vlerësimit të konformitetit. Ajo nuk ofron shërbime të konsulencës, nuk mund të ketë aksione ose interesa financiarë apo drejtimi në ndonjë organ të vlerësimit të konformitetit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili është nëpunës civil dhe ka autoritetin e përgjegjësive për marrjen e vendimit për akreditimin. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Për punonjësit administrativë, marrëdhëniet e punës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

6. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit siguron paanshmëri dhe objektivitet në marrjen e vendimit për akreditimin. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit miratohet me urdhër të Kryeministrit.

7. Ministria mbështet Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit në anëtarësimin e saj në strukturat e Organizatës Europiane për Akreditimin dhe në organizmat ndërkombëtarë të akreditimit.

8. Organizimi dhe mënyra e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 5

#### Procesi i akreditimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton:

- a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues;
- b) organe certifikuese të sistemeve të menaxhimit;
- c) organe certifikuese të personelit;
- ç) organe certifikuese të produkteve;
- d) organe inspektuese;
- dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike;
- e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.

2. Akreditimi për çdo fushë të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, bëhet kundrejt tarifave të akreditimit, të paguara nga organi i vlerësimit të konformitetit. Llojet, masa dhe mënyra e pagesës së tarifave për çdo fushë akreditimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kryen trajnime për palët e treta, kundrejt tarifave përkatëse. Llojet, masa dhe mënyra e pagesës së këtyre tarifave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit vlerëson nëse një organ i vlerësimit të konformitetit është kompetent për të kryer aktivitete specifike të vlerësimit të konformitetit dhe lëshon një certifikatë akreditimi për ta zyrtarizuar këtë.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit mbikëqyr çdo organ të vlerësimit të konformitetit, të cilit i ka lëshuar certifikatë akreditimi.

6. Për vlerësimin/mbikëqyrjen e kompetencës teknike të organeve të vlerësimit të konformitetit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit krijon një grup me specialistë vlerësues të institucionit dhe/ose të jashtëm, vendas apo të huaj, të cilët veprojnë gjithmonë në emër të këtij institucioni.

7. Shpenzimet e akreditimit, kur vlerësuesi teknik është i huaj, përfshijnë:



a) pagesën e vlerësuesit, sipas tarifave të vendit të origjinës, por, gjithmonë, në marrëveshje me organin e vlerësimit të konformitetit që ka aplikuar për akreditim;

b) shpenzimet e akomodimit (fjetje, ushqim) dhe transport;

c) çdo tarifë tjetër të procesit të akreditimit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Kur vlerësimi teknik bëhet nga vlerësues vendas, tarifa e akreditimit përfshin tarifat e përcaktuara sipas pikës 2 të këtij neni. Masa e pagesës së vlerësuesve vendas që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Pagesat e vlerësuesve teknikë, të huaj dhe atyre vendas, që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, nga të ardhurat, sipas pikës 2 të nenit 15, të këtij ligji.

10. Në rast se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit konstaton që një organ i vlerësimit të konformitetit nuk është më kompetent për të kryer një veprimtari të veçantë të vlerësimit të konformitetit ose kur ai ka kryer një shkelje serioze të detyrimeve të tij, ajo merr masat e duhura brenda një kohe të arsyeshme për të reduktuar, pezulluar ose tërhequr certifikatën e tij.

Procedurat e reduktimit, pezullimit ose tërheqjes së akreditimit miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe bëhen publike.

11. Procedurat për trajtimin e apeliave përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe bëhen publike.

#### Neni 6

### **Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit**

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit ka këto përgjegjësi:

a) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë dhe europianë të akreditimit;

b) bashkëpunon me organizmat kombëtarë të akreditimit në vendet e tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare, apo për të arritur marrëveshje dypalëshe;

c) këshillon administratën shtetërore për çështje që lidhen me akreditimin dhe vlerësime të tjera të kompetencës teknike, për kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike;

ç) mban, përditëson dhe jep të dhëna për statusin e akreditimit të organeve të akredituara;

d) bashkëpunon me të gjitha palët e interesuara për çështjet e akreditimit;

dh) kryen trajnime për fushën e akreditimit;

e) merr të dhëna nga organizmat akreditues të vendeve të tjera për organet e akredituara prej tyre, të cilët kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë;

ë) u vendos gjoha subjekteve të paakredituara apo atyre që u ka mbaruar akreditimi, në rastet kur ato përdorin simbolin e akreditimit;

f) trajton ankesat dhe apeliave për akreditimin, të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit;

g) mbështet autoritetet miratuese në procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së degëve të organeve europiane që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kreun V, të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.

#### Neni 7

### **Parimet e jokonkurrueshmërisë**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk konkurren me organet e vlerësimit të konformitetit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk konkurren me organizmat kombëtarë të akreditimit në vendet e tjera.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ofron shërbimin e akreditimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar parimet e Organizatës Europiane për Akreditimin për marrëdhëniet ndërkufitare midis organizmave akreditues.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit operon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me kërkesën e një organi vlerësimi konformiteti që është në rrethana të njëjta me një organ vlerësimi konformiteti shqiptar, referuar pikës 1, të nenit 8, të këtij ligji, ose me kërkesën e një organizmi akreditues të huaj.

Kur Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit merr një kërkesë për akreditim nga një organ



vlerësimi konformiteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ajo informon organizmin kombëtar të akreditimit të vendit ku është vendosur organi i vlerësimit të konformitetit. Në të tilla raste, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit fton organizmin akreditues të vendit përkatës të marrë pjesë si vëzhgues në procedurën e vlerësimit.

Neni 8

### **Marrëdhëniet ndërkufitare midis organizmave akreditues**

1. Një organ i vlerësimit të konformitetit, i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të kërkojë akreditim në një organizëm akreditues të huaj në rastet kur:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk ofron akreditim për fushën ku organi i vlerësimit të konformitetit dëshiron të akreditohet;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk ka kryer vlerësim të ndërsjellë ose nuk ka nënshkruar marrëveshje të njohjes së ndërsjellë, në fushën ku organi i vlerësimit të konformitetit kërkon të akreditohet.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit mund të kërkojë një organizëm akreditues të huaj të kryejë një pjesë të vlerësimit në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Certifikata e akreditimit lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

### **KREU III**

### **KRITERET PËR ORGANIZMIN KOMBËTAR TË AKREDITIMIT**

Neni 9

#### **Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit**

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit siguron pavarësinë nga organet e vlerësimit të konformitetit.

2. Çdo vendim në lidhje me akreditimin merret duke ruajtur parimin e kompetencës profesionale.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit siguron që çdo vendim në lidhje me akreditimin është marrë nga persona kompetentë, të ndryshëm nga ata që kryejnë vlerësimin.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit merr masa të përshtatshme për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit të marrë.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit organizohet dhe vepron në mënyrë që të mbrojë objektivitetin dhe paanshmërinë e aktiviteteve të saj.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit identifikon aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat është kompetente për të ofruar akreditimin, sipas legjislacionit dhe standardeve përkatëse të Bashkimit Europian ose atyre kombëtare.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit krijon procedurat e nevojshme për të siguruar menaxhimin efikas dhe kontrollet e duhura të brendshme.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ka në dispozicion një numër personeli, kompetent dhe të mjaftueshëm, për kryerjen në nivelin e duhur të detyrave të saj.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit krijon, zbaton dhe mban procedurat për monitorimin e performancës dhe kompetencës së personelit të përfshirë në procesin e akreditimit.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit përcakton detyrat, përgjegjësitë dhe autoritetet e personelit, që mund të ndikojnë në cilësinë e vlerësimit dhe njohjes së kompetencës.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit verifikon që vlerësimet e konformitetit kryhen në mënyrën e duhur, pavarësisht nga madhësia e një organi të vlerësimit të konformitetit, sektori në të cilin ai vepron, struktura e tij, shkalla e kompleksitetit të teknologjisë të produktit apo natyra e procesit të prodhimit.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit publikon llogaritë e shpenzimeve vjetore dhe të ardhurat.

13. Për nevojat e veta, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit mund të krijojë grupe teknike pune të përhershme apo *ad-hoc*, të përbëra nga specialistë të fushave të caktuara, të cilët hartojnë kërkesat e veçanta për akreditimin në fushën përkatëse.

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë specialistët për anëtarë të grupeve teknike të punës përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për tregtinë. Masa e shpërblimit të anëtarëve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përzgjedhja e anëtarëve dhe ngritja e grupeve teknike bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Akreditimit, mbështetur në nevojat konkrete.



## Neni 10

**Ngritja e bordit të akreditimit**

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit krijohet bordi i akreditimit, i cili ka këto detyra kryesore:

a) merr pjesë në hartimin e strategjisë së zhvillimit të akreditimit, që është pjesë e strategjisë kombëtare të mbrojtjes së konsumatorit, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) përcakton objektivat kryesorë të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit;

c) analizon përmbushjen e detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, në zbatim të programit të saj të punës;

ç) trajton ankesat dhe apelimet në lidhje me akreditimin.

## Neni 11

**Përbërja e bordit të akreditimit**

1. Bordi i akreditimit ka 16 anëtarë. Përfaqësimi i tyre është i balancuar dhe me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara.

2. Bordi i akreditimit përbëhet nga:

a) 6 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë e tregtinë, bujqësinë dhe ushqimin, çështjet e mjedisit, ndërtimin, sigurinë e shëndetit dhe të jetës në punë;

b) 2 përfaqësues nga organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara;

c) 1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve;

ç) 1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;

d) 2 përfaqësues nga organizatat e biznesit;

dh) 2 përfaqësues nga shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve;

e) 2 përfaqësues nga institucionet shkencore.

3. Bordi i akreditimit funksionon në bazë të rregullores, që miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet e tregtisë. Në rregullore përcaktohen edhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit të bordit. Masa e shpërblimit për anëtarët e bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Përbërja nominative e anëtarëve të bordit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për tregtinë.

## Neni 12

**Përputhshmëria me kërkesat për organizmat kombëtarë të akreditimit**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ndërton, vë në funksionim dhe mirëmban sistemin e menaxhimit të cilësisë së saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet ndërkombëtare dhe dokumentet e organizatave europiane e ndërkombëtare të akreditimit. Ajo demonstroi përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në standardet përkatëse të harmonizuara nëpërmjet rezultateve pozitive nga vlerësimet e ndërsjella.

2. Ministria siguron që Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të ketë burime të përshtatshme financiare dhe personeli për kryerjen e saktë të detyrave të saj, duke përfshirë edhe plotësimin e detyrave të veçanta, si veprimtari për akreditimin europian e ndërkombëtar dhe veprimtari që kërkohen për të mbështetur politika publike, të cilat nuk janë të vetëfinancueshme.

3. Ministria kontrollon veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit për të siguruar përmbushjen në mënyrë të vazhdueshme të kërkesave të referuara në nenet 9, 10 dhe 11 të këtij ligji. Në rastet kur vlerëson se kjo veprimtari nuk përputhet me këto kërkesa, ajo merr masa korigjuese.

4. Për vlerësimin e rezultatit të kontrollit, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, ministria mbështetet maksimalisht në rezultatet e vlerësimit të kryer nga Organizata Europiane për Akreditimin.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, nëpërmjet bordit, trajton ankesat kundër organeve të vlerësimit të konformitetit, që ajo ka akredituar.

## Neni 13

**Vlerësimi i ndërsjellë**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit i nënshtrohet vlerësimit të ndërsjellë, siç përcaktohet nga Organizata Europiane për Akreditimin.

2. Ministria siguron kryerjen e vlerësimeve të ndërsjella apo në mënyrë periodike në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit. Palët e interesuara kanë të drejtë të marrin pjesë në fazën e plotësimit të kërkesave të Organizatës Europiane për Akreditimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, por nuk marrin pjesë në procesin direkt të vlerësimit të ndërsjellë të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.



3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit njeh barasvlerën e shërbimeve të kryera nga organizma kombëtarë të akreditimit të vendeve të tjera, të cilët kanë rezultate pozitive në vlerësimet e ndërsjella.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon të gjithë organizmat kombëtarë të akreditimit të vendeve të tjera në lidhje me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit që ajo akrediton dhe ndryshimet në to.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon në lidhje me rezultatet e vlerësimeve të ndërsjella për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të cilat ajo akrediton.

Neni 14

**Prezumimi i konformitetit për organizmat kombëtarë të akreditimit dhe detyrimet e informimit**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit prezumohet se plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 9, të këtij ligji, kur ajo demonstroi përputhshmërinë me standardet e harmonizuara shqiptare përkatëse dhe kur ka kaluar me sukses vlerësimin e ndërsjellë, të organizuar nga Organizata Europiane për Akreditimin.

2. Autoritetet kombëtare njohin barasvlerën e shërbimeve të ofruara nga organizmat akreditues të cilat kanë kaluar me sukses vlerësimin e ndërsjellë, sipas nenit 13, dhe pranojnë në bazë të prezumimit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, certifikatat e akreditimit dhe dëshmitë të lëshuara prej tyre.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon organizmat e tjerë kombëtarë të akreditimit në lidhje me akreditimin e aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit, me të cilat ajo operon dhe çdo ndryshim të tyre.

Neni 15

**Të ardhurat**

1. Të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit derdhen në Buxhetin e Shtetit.

2. Të ardhurat e krijuara sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 5, përdoren në masën 90 për qind nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për pagesën e vlerësuesve teknikë vendas që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, apo vlerësuesve teknikë të huaj, si

dhe për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit e transportit të vlerësuesve teknikë të huaj.

KREU IV

**KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

Neni 16

**Kundërvajtjet**

Përdorimi i simbolit të akreditimit nga subjekte të paakredituara apo që u ka mbaruar afati i akreditimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë. Gjobat vendosen nga punonjësi i autorizuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Të ardhurat e mbledhura nga gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 17

**Ankimi administrativ**

1. Ankimi kundër vendimit të dënimit administrativ mund të bëhet, brenda 15 ditëve nga marrja e tij, te Drejtori i Përgjithshëm i Akreditimit, i cili duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve nga data e ankimit.

2. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Akreditimit, ose kur ai nuk përgjigjet ndaj ankimit të depozituar, mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda 30 ditëve.

KREU V

**DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 18

**Aktet nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave miraton, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore të parashikuara në pikën 8 të nenit 4, në pikat 2, 3 dhe 8 të nenit 5, në pikën 13 të nenit 9 dhe në nenin 11.

2. Ministri përgjegjës për tregtinë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore të parashikuara në pikën 11 të nenit 5, në pikën 13 të nenit 9 dhe në nenin 11.

Neni 19

**Dispozitë kalimtare**

Certifikatat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten të vlefshme deri në përfundimin e rregullt të afatit të përcaktuar në to.



Neni 20  
Shfuqizime

Ligji nr. 9824, datë 1.11.2007, “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore që bien ndesh me të shfuqizohen.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.9.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8727, datë 3.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**  
Nr. 117/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT  
EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN E  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
PROGRAMIN “ERASMUS +”, PROGRAMI  
I BE-SË PËR ARSIMIN, TRAJNIMIN,  
RININË DHE SPORTIN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Erasmus +”, programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.9.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8728, datë 3.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

ANEKS

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN DHE  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI  
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË NË “ERASMUS +”  
PROGRAMI I BE-SË PËR ARSIMIN,  
TRAJNIMIN, RININË DHE SPORTIN**

Komisioni European, referuar më poshtë si “Komisioni”, në emër të Bashkimit European, nga njëra anë, dhe

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, referuar më poshtë si “Shqipëria” nga ana tjetër,

Duke pasur parasysh se:

1. Një Marrëveshje Kuadër është nënshkruar më 22 nëntor të vitit 2004 ndërmjet Komunitetit European dhe Republikës së Shqipërisë<sup>2</sup>, e cila përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Bashkimit European. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon që termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë edhe kontributin financiar për pjesëmarrjen e Shqipërisë në secilin program të veçantë, do të përcaktohen nga Komisioni dhe qeveria e Shqipërisë.

2. “Erasmus+”: Programi i Bashkimit European për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin është hartuar në përputhje me rregulloren (BE) nr. 1288/2013 të Parlamentit dhe Këshillit European, më 11 dhjetor 2013<sup>3</sup>.

3. Subjektet rezidente në Shqipëri kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet periodike që zhvillohen përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kostot e përfshira për këto aktivitete që zbatohen gjatë vitit 2014 mund të konsiderohen të rimbursueshme sipas të njëjta kushteve si ato të aplikuara për subjektet rezidente në vendet anëtare të BE-së, me kusht që kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi para përfundimit të veprimit përkatës.

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1  
**Programi**

Shqipëria do të marrë pjesë në “Erasmus+”: Programi i Bashkimit për arsimin, trajnimin,

<sup>2</sup> FZ L 192.22.07.2005, f. 2

<sup>3</sup> FZ L 347.20.12.2013, f. 50





rininë dhe sportin (më poshtë i quajtur “Programi”), në përputhje me kushtet e vendosura në Marrëveshjen Kuadër të datës 22 nëntor 2004 ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit Europian dhe sipas termave dhe kushteve të përmendura në nenet 2-5 të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 2

### Termat dhe kushtet e pjesëmarrjes në Program

Shqipëria do të marrë pjesë në veprimtaritë e Programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregulloren (BE) nr. 1288/2013 dhe sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

a) Për sa kohë që Shqipëria nuk përmbush kushtet e pjesëmarrjes së plotë në Program, ajo do të marrë pjesë në mënyrë të barabartë si shtetet anëtare të BE-së, në veprime të cilat nuk menaxhohen nga agjencitë kombëtare në platformat mbështetëse të teknologjisë së informacionit (duke e përfshirë *Twining*) dhe do të përfitojë mbështetje për reformat politike.

b) Shqipëria do të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e Programit duke filluar nga data 1 janar pas vitit të pranimit nga Komisioni i Vlerësimit *ex ante* të përputhshmërisë së Agjencisë Kombëtare nga autoriteti kombëtar sipas përcaktimeve të bëra në nenin 27(4) dhe në përputhje me nenin 29 të rregullores (BE) nr. 1288/2013.

Termat dhe kushtet që duhen zbatuar për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve dhe për implementimin e aktiviteteve nga institucionet, organizatat dhe individët përfaqësues nga Shqipëria, duhet të jenë të njëjtë me termat të cilët aplikohen për organizatat dhe individët përfaqësues të shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria duhet t’i paguajë çdo vit një kontribut financiar Buxhetit të Përgjithshëm të Bashkimit Europian në përputhje me nenin 3 më poshtë.

Kontributi financiar i Shqipërisë për pjesëmarrjen e saj dhe për zbatimin e Programit në Shqipëri, do t’i shtohet shumës të caktuar çdo vit në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit

Europian për angazhimin e ndarjeve buxhetore për të përmbushur detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe operimin e Programit.

Një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian do të përdoret për procedurat që kanë të bëjnë me kërkesat, kontratat, raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

#### Neni 3

### Kontributi financiar

Rregullat që menaxhojnë procedurat për kontributin financiar të Shqipërisë përcaktohen në aneksin I.

#### Neni 4

### Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës Europiane të Auditimit në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet vazhdimisht mbi baza partneriteti, ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit. Shqipëria do t’i paraqesë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitetet e tjera specifike të parashikuara nga Bashkimi Europian në atë kuadër.

Rregullat për kontrollin financiar, rimbursimin dhe për masat e tjera kundër mashtrimit përcaktohen në aneksin II.

#### Neni 5

### Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje do të zbatohet gjatë të gjithë kohëzgjatjes së Programit. Megjithatë, nëse Bashkimi Europian vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së Programit pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda tij, kjo Marrëveshje, gjithashtu, do të zgjatet sipas rrethanave dhe automatikisht nëse asnjëra palë nuk paraqet ankesa ndaj saj brenda një muaji nga hyrja në fuqi e aktit ligjor për shtyrjen e Programit.

Projektet dhe aktivitetet në vijim do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Gjithashtu, do të plotësohen deri në fund edhe marrëveshjet e kontaktuar që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete, sipas dispozitave të aneksit II.



Anekset janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqim të përbashkët të palëve.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim nëpërmjet së cilës Shqipëria njofton Komisionin nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi përmbushjen e kërkesave të saj të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Efektet financiare të kësaj Marrëveshjeje fillojnë që nga data 1 janar 2014.

Bërë në, më  
Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë  
/Emri//Emri/  
Ministër i (ministria)  
Republikës së Shqipërisë

Bërë në, më  
Për Komisionin  
Në emër të Bashkimit Evropian  
/Emri/  
Anëtar i Komisionit  
Për (departamenti)

#### ANEKSI I

#### RREGULLAT QË QEVERISIN KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË “ERASMUS+”: PROGRAMI I BASHKIMIT PËR ARSIMIN, TRAJNIMIN, RININË DHE SPORTIN

Për sa kohë Shqipëria nuk i përmbush kushtet për pjesëmarrjen e plotë në Program, kontributi financiar vjetor për t'u paguar nga Shqipëria ndaj Buxhetit të Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Program, do të jetë 90.000 euro.

Që nga 1 janari pas vitit të pranimit nga Komisioni, përpara vlerësimit të aplikimit të Agjencisë Kombëtare nga autoritetet vendase, siç referohet në nenin 27(4) të rregullores (BE) nr. 1288/2013 dhe në përputhje me nenin 29(2), Shqipëria do të paguajë një kontribut vjetor të rishikuar për të marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë e Programit. Kontributi i Shqipërisë do të miratohet me shkrim me pëlqimin e përbashkët të palëve.

Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë shpenzimet në lidhje me përgatitjen, realizueshmërinë, zhvillimin dhe ekzekutimin e projekteve me interes të përbashkët, si dhe për

zhvillimin dhe zbatimin e masave horizontale të parashikuara në Program.

Shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës që bëhen nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllimin e pjesëmarrjes si vëzhgues në punën e Komitetit të përmendur në nenin 36 të rregullores (BE) nr. 1288/2013, ose mbledhje të tjera në lidhje me zbatimin e Programit do të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtat baza dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 25 tetor 2012 mbi rregullat financiare të zbatueshme në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian do të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

Kur kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe në fillim të secilit vit pasues buxhetor, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë një kërkesë për fonde që korrespondon me kontributin e saj të kostos që mbulon kjo Marrëveshje.

Ai kontribut do të paguhet në euro në një llogari bankare të Komisionit që është në euro.

Shqipëria do të paguajë kontributin e saj të shpenzimeve vjetore në përputhje me kërkesën për fonde jo më vonë se tre muaj pas datës së kërkesës. Çdo vonesë në pagesën e kontributit do të shkaktojë pagesën e kamatëvonesave nga Shqipëria mbi shumën e papaguar nga data e kërkuar.

Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të shlyerjes, siç janë publikuar në seritë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilën hyn afati i fundit, duke u rritur me 3.5 pikë për qind. Nëse vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që rrezikon zbatimin dhe menaxhimin e Programit, dhe në mungesë të pagesës për 20 ditë pune pas letrës zyrtare të dërguar për kujtesë Shqipërisë nga Komisioni, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program për vitin përkatës do të pezullohet.



## ANEKSI II

KONTROLI FINANCIAR, RIMËKEMBJA  
DHE MASA TË TJERA KUNDËR  
MASHTRIMITI. KONTROLLE DHE MASA TË TJERA  
KUNDËR MASHTRIMIT NGA BE-ja

1. Në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Europian, si dhe rregullore të tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura me kontraktuesit dhe përfituesit e vendosur në Shqipëri, do të sigurojnë që financime dhe auditime të tjera të kryhen në çdo kohë gjatë zbatimit të kontratës ose të marrëveshjes së grantit për një periudhë 5-veçare duke filluar nga data e pagesës së balancës, përveç për grante të një shume të barabartë ose më të ulët se 60.000 euro për të cilën kjo periudhë do të kufizohet në 3 vjet. Auditimet financiare dhe të tjera do të kryhen në ambientet e kontraktuesve dhe nënkontraktuesve nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë aksesin e duhur në faqet elektronike, punë, dokumente dhe të gjithë informacionin e kërkuar, në mënyrë që një auditim i tillë të kryhet duke përfshirë edhe atë në formë elektronike. Kjo e drejtë për akses do të shprehet qartë në kontratat dhe në Marrëveshjet e Grantit të lidhura për të zbatuar instrumentet e kësaj Marrëveshjeje. Gjykata Europiane e Auditëve do të ketë të njëjta të drejta si Komisioni.

3. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni/OLAF (Zyra Europiane Kundër Mashtrimit) do të autorizohet për të kryer kontrolle dhe inspektime në vend në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat procedurale të rregullores së Këshillit (Euratom, BE) nr. 2185/96 të datës 11 nëntor 1996<sup>4</sup>.

Këto kontrolle dhe inspektime do të përgatiten dhe do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Shqipërisë, të përcaktuara nga autoritetet shqiptare, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që ata të mund të japin të gjithë ndihmën e kërkuar.

Nëse autoritetet shqiptare dëshirojnë kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me to.

Kur pjesëmarrësit e Programit i rezistojnë një kontrolli ose inspektimi, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me ligjet kombëtare, do t'i japin ndihmën e nevojshme inspektorëve të Komisionit/OLAF-it për t'i lejuar të kryejnë detyrën e tyre në realizimin e një kontrolli ose inspektimi në vend.

Komisioni/OLAF-i duhet t'i raportojë autoriteteve shqiptare, sa më shpejt të jetë e mundur, çdo fakt apo dyshim në lidhje me ndonjë parregullsi, e cila ka ardhur në vëmendje të tyre gjatë kontrollit ose inspektimit në vend.

Në çdo rast, Komisionit/OLAF-it do t'i kërkohet të informojë autoritetet e sipërpërmendura mbi rezultatin e këtyre kontrolleve apo inspektimeve.

## II. INFORMIMI DHE KONSULTIMI

1. Me qëllimin e zbatimit të duhur të këtij aneksi, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe të Bashkimit Europian do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe me kërkesë të njëres nga palët do të kryejnë konsultime.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë pa vonesë Komisionin për çdo fakt apo dyshim, i cili është sjellë në vëmendje të tyre në lidhje me një parregullsi mbi lidhjen dhe zbatimin e instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje.

III. MASAT ADMINISTRATIVE DHE  
GJOBAT

Pa cenuar zbatimin e legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Europian.

## IV. RIMËKEMBJA

Vendimet e marra nga Komisioni brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, të cilat vendosin një detyrim monetar ndaj personave të ndryshëm nga shtetet, do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri. Zbatimi i vendimit do të kryhet në përputhje me rregullat e procedurës civile në fuqi në territorin e shtetit ku do të zbatohet. Urdhri i ekzekutimit do t'i bashkëlidhet vendimit pa formalitete të tjera përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit nga autoriteti kombëtar që do ta caktojë qeveria e Shqipërisë për këtë qëllim dhe do t'i bëhet i ditur Komisionit. Kur këto formalitete të jenë plotësuar për aplikim nga

<sup>4</sup> FZ L 292. 15.11.1996, f. 2



Komisioni, ky i fundit mund të procedojë për ekzekutimin në përputhje me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt para autoriteteve kompetente. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata e Bashkimit Europian.

Vendimet e marra nga Gjykata e Bashkimit Europian në pajtim me një klauzolë arbitrazhi në një marrëveshje granti dhe në një kontratë brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të detyrueshme në bazë të të njëjta kushteve.

#### V. KOMUNIKIMI I DREJTPËRDREJTË

Komisioni do të komunikojë drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në “Erasmus+”, Programi i Bashkimit për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin, i vendosur në Shqipëri. Ata do të paraqesin drejtpërdrejt te Komisioni të gjithë informacionin dhe dokumentin e duhur të cilin u kërkohet ta paraqesin mbi bazën e instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje dhe kontratat ose marrëveshjet e grantit të lidhura për zbatimin e tyre.

### LIGJ

Nr. 118/2014

## PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR THEMELIMIN DHE STATUTIN E ORGANIZATËS EUROPIANE TË SË DREJTËS PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

#### Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për themelimin dhe statutin e Organizatës Europiane të së Drejtës Publike.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.9.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8729, datë 3.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

### MARRËVESHJE

## PËR THEMELIMIN DHE STATUTIN E ORGANIZATËS EUROPIANE TË SË DREJTËS PUBLIKE

Palët e kësaj Marrëveshjeje,

*Duke njohur* rëndësinë e së drejtës publike *lato sensu*, si dhe nevojën për të nxitur më tej karakterin shkencor, kërkimor, arsimor, trajnues, ndërtimit institucional dhe dimensionet e tjera për një brez më të mirë avokatësh dhe institucionesh demokratike në të gjithë botën, dhe promovimin e vlerave europiane nëpërmjet së drejtës publike në të gjithë botën;

*Duke besuar* se tashmë ekziston dëshira që të themelohet një Organizatë Europiane e së Drejtës Publike (OEDP), si një organizatë ndërkombëtare me udhëheqjen e duhur, personalitet dhe status të plotë juridik ndërkombëtar;

*Duke vërejtur* dëshirën e palëve nënshkruese për të promovuar dhe mbështetur aktivitetet e Organizatës Europiane të së Drejtës Publike jashtë çdo faktori politik;

*Duke vërejtur* gatishmërinë e Republikës Helene për të pranuar që selia e Organizatës Europiane të së Drejtës Publike të vendoset në Greqi, pasi Organizata Europiane e së Drejtës Publike të ketë marrë statusin ndërkombëtar;

*Kanë rënë dakord* si më poshtë:

### PJESA I

#### THEMELIMI DHE STATUSI

#### Neni 1

#### Organizata

1. Organizata Europiane e së Drejtës Publike është themeluar si një organizatë ndërkombëtare, më poshtë e quajtur “Organizata” ose “OEDP”.

2. OEDP-ja zotëron personalitet të plotë juridik ndërkombëtar dhe gëzon këto kapacitete, siç mund të jetë e nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e qëllimeve të saj.

3. Faktorët politikë nuk ndikojnë tek aktivitetet, menaxhimi dhe personeli i Organizatës.

4. Organizata operon në përputhje me këtë Marrëveshje.



## Neni 2

**Qëllimet dhe aktivitetet**

1. Qëllimi i Organizatës është krijimi dhe përhapja e njohurive në fushën e së drejtës publike *lato sensu*, duke përfshirë, ndër të tjera, të drejtën publike kombëtare, krahasuese dhe europiane, legjislacionin mbi të drejtat e njeriut, të drejtën mjedisore etj., si edhe promovimin e vlerave europiane nëpërmjet së drejtës publike në të gjithë botën. Për këtë qëllim, Organizata do të organizojë dhe mbështesë aktivitetet shkencore, kërkimore, arsimore, trajnuese, mësimdhënëse, ndërtimin e kapaciteteve dhe aktivitete të tjera, si dhe do të ofrojë ndihmë për institucionet demokratike në Europë dhe në të gjithë botën.

2. Për të përmbushur qëllimet e saj, Organizata mund të angazhohet në të gjitha llojet e aktiviteteve, siç edhe do të përshkruhet hollësisht në rregulloren e saj, dhe që organet e saj mund të zhvillojnë më tej dhe do të nxisin bashkëpunimin me institucione, organizata dhe organizma të tjerë, në veçanti, me organizata në sistemin e Kombeve të Bashkuara.

## Neni 3

**Selia**

1. Selia e Organizatës do të jetë në Athinë, Greqi.

2. Organizata mund të hapë zyra dhe degë në vendndodhje ose shtete të tjera, siç kërkohet për të mbështetur programet dhe aktivitetet e saj.

## Neni 4

**Kompetencat**

Për të ndjekur më tej qëllimet dhe aktivitetet e saj, Organizata do të ketë kompetencat e plota të çdo organizate me personalitet ndërkombëtar juridik dhe, ndër të tjera, kompetencat e mëposhtme:

1. Të njohë dhe të disponojë pronën reale dhe personale;
2. Të hyjë në kontrata dhe tipa të tjerë marrëveshesh;
3. Të punësojë individë;
4. Të fillojë dhe të realizojë mbrojtje gjatë procedimeve ligjore;
5. Të investojë shumat financiare dhe pronat e Organizatës;

6. Të lidhë marrëveshje me shtete dhe organizata të tjera ndërkombëtare; dhe

7. Të ndërmarë veprime të tjera të ligjshme, të nevojshme për të përmbushur qëllimet e Organizatës, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje dhe siç paraqitet hollësisht në rregulloren e saj.

## Neni 5

**Të drejtat, privilegjet dhe imunitetet**

1. OEDP-ja, zyrtarët e saj dhe personeli do të gëzojnë brenda territoreve të shteteve anëtare privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në “Konventën mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara”, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 13 shkurt 1946, pasi ato janë të nevojshme për ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në përputhje me parimet dhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Për komunikimin e saj zyrtar, OEDP-ja do të gëzojë në çdo shtet anëtar trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i dhënë nga ai shtet për misionet diplomatike të ndonjë shteti tjetër. Asnjë censurim nuk duhet të aplikohet ndaj korrespondencës zyrtare dhe komunikimeve të tjera zyrtare të OEDP-së. Asnjë censurim nuk do të aplikohet ndaj publikimeve, imazheve të lëvizshme dhe të palëvizshme, filmave dhe regjistrimeve zanore të OEDP-së.

3. Gjithashtu, Organizata, zyrtarët dhe personeli i saj do t'i gëzojnë në shtetin e selisë këto të drejta, privilegje dhe imunitete që kërkohen për përmbushjen e funksioneve të tyre. Këto privilegje dhe imunitete përfshihen në një marrëveshje për selinë, e cila do të lidhet me qeverinë e Republikës Helene. Shtete të tjera mund të ofrojnë të drejta, privilegje dhe imunitete të ngjashme në mbështetje të aktiviteteve të Organizatës në këto vende.

## Neni 6

**Marrëdhëniet bashkëpunuese**

1. Organizata do të angazhohet në marrëdhënie bashkëpunuese me institucione dhe programe të tjera, duke përfshirë universitetet, qendrat kërkimore, ministritë, autoritetet vendore, parlamentet, gjykatat etj., dhe do të nxisë bashkëpunimin institucional. Ky bashkëpunim do të përcaktohet hollësisht në rregulloren e saj.



2. Organizata mund të pranojë personel mbi baza huaje ose transferimi nga palët pjesëmarrëse në Marrëveshje dhe personel tjetër.

## PJESA II ORGANIZIMI

### Neni 7 Organet

OEDP-ja përbëhet nga Asambleja e Përgjithshme (më poshtë e quajtur “Asambleja”), Bordi i Drejtorëve (më poshtë i quajtur “Bordi”), Komiteti Ekzekutiv, Këshilli Shkencor European, drejtori dhe personeli.

### Neni 8 Asambleja

1. Çdo Palë e kësaj Marrëveshjeje do të caktojë një përfaqësues, i cili do të jetë anëtar i Asamblesë. Çdo palë, përveç përjashtimit të parashikuar në nenin XXI, paragrafi 2, do të ketë një votë të plotë në Asamble.

2. Asambleja do të zhvillojë sesione të rregullta çdo dy vjet gjatë për rishikimin e aktiviteteve të Organizatës, si edhe përbërjen e Bordit dhe Komitetit Ekzekutiv. Gjatë takimeve të saj të rregullta Asambleja do të miratojë politikat e përgjithshme dhe buxhetin e Organizatës, si edhe do të regjistrojë pasqyrat financiare të audituara, të paraqitura nga Bordi i Drejtorëve.

3. Mund të thirren sesione të jashtë-zakonshme me ftesë të Bordit të Drejtorëve apo me iniciativën e një së tretës së anëtarëve të Asamblesë me votë të plotë.

4. Çdo veprim i Asamblesë, i cili do të kërkonte një votë të anëtarëve të Asamblesë personalisht, do të jetë njëllor i vlefshëm nëse merret në bazë të pëlqimit me shkrim të këtyre anëtarëve në vend të një takimi.

5. Kur arrihet kuorumi i shumicës së anëtarëve me votë të plotë, vendimet e Asamblesë do të merren me votë shumice midis palëve me votë të plotë të pranishëm në diskutime, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje ose rregullore.

### Neni 9 Bordi i Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve do të përbëhet nga drejtori në rolin e presidentit, anëtarët e Komitetit

Ekzekutiv dhe përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse, organizatave ndërkombëtare apo të institucioneve ose programeve të tjera me të cilat OEDP-ja krijon marrëdhënie bashkëpunimi. Gjithashtu, OEDP-ja do të ftojë të marrë pjesë në Bord edhe një zyrtar/punonjës të personelit, i cili është anëtar i Komisionit European.

Përfaqësuesit e institucioneve apo të programeve me të cilat OEDP-ja krijon marrëdhënie bashkëpunimi, si edhe anëtarët e kësaj Marrëveshjeje, të cilët nuk kanë votë të plotë në Asamble, do të marrin pjesë në Bord me një votë konsultative, me përjashtim të rasteve të aktiviteteve në të cilat ata marrin pjesë në mënyrë aktive. Devijime nga ky rregull mund të përcaktohen hollësisht në rregulloren e Organizatës.

2. Anëtarët e Bordit do të caktohen pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe, më pas, sa herë që të jetë e nevojshme, pas konsultimeve me çdo palë, institucion etj., të përfaqësuar me vendim të drejtorit. Pas caktimit, anëtarët e Bordit do të veprojnë në cilësitë e tyre personale dhe nuk do të kenë detyrimin ligjor nga direktivat nga qeveritë apo organizatat e tyre.

3. Bordi do të takohet të paktën një herë në vit për të përmbushur funksionet e tij, të cilat përfshijnë miratimin e politikës së përgjithshme të OEDP-së dhe buxhetit, si edhe të regjistrojë pasqyrat financiare të audituara.

4. Pas arritjes së kuorumit të shumicës së anëtarëve me votë të plotë, vendimet e Bordit do të merren nga një votë shumice midis anëtarëve me votë të plotë, të cilët janë të pranishëm në diskutime, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje apo rregullore.

5. Bordi do të lëshojë rregulloren për objektivat e hollësishtë dhe për drejtimin e Organizatës në përputhje me dhe në plotësim të kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 10 Komiteti Ekzekutiv

1. Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga katër individë të përzgjedhur në bazë të arritjeve të tyre profesionale në fushat shkencore të Organizatës, të cilët jetojnë në vendin e selisë, si edhe nga drejtori në rolin e Presidentit.

2. Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv do të caktohen pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje



dhe, më pas, sa herë që të jetë e nevojshme, në parim midis anëtarëve të Këshillit Shkencor Europian, me vendim të drejtorit.

3. Komiteti Ekzekutiv do të diskutojë dhe do të miratojë aktet e menaxhimit të përditshëm të Organizatës, të cilat rregullorja nuk do t'ia besojë vetëm drejtorit.

4. Kur të arrihet kuorumi i shumicës së anëtarëve, vendimet e Komitetit Ekzekutiv do të merren me shumicë votash midis anëtarëve, të cilët janë të pranishëm në diskutime, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje apo rregullore.

Neni 11

### **Këshilli Shkencor Europian**

1. Këshilli Shkencor Europian (KSHE) do të jetë organ konsultativ për Bordin e Drejtorëve.

2. KSHE-ja në kuorum është i pavarur nga numri i anëtarëve të tij të pranishëm në diskutime.

3. KSHE-ja zgjedh midis anëtarëve të tij një president për periudha trevjeçare, me të drejtë rinovimi të mandatit.

Neni 12

### **Drejtori**

1. Organizata do të operojë nën udhëheqjen e një drejtori, i caktuar nga Bordi, sipas këshillave të KSHE-së, duke ndjekur një procedurë të veçantë të parashikuar në rregullore. Drejtori do të përzgjidhet bazuar në arritjet e tij/saj profesionale në fushat shkencore të Organizatës dhe në aftësitë e tij/saj profesionale. Ai/ajo duhet të banojë në shtetin e selisë.

2. Drejtori do të jetë përgjegjës për funksionimin dhe menaxhimin e Organizatës në përputhje me këtë marrëveshje, rregulloren dhe politikën e tjera të vendosura nga organet kompetente.

Neni 13

### **Personeli**

1. Drejtori do të caktojë atë personel për Shërbimet Profesionale dhe të Përgjithshme që mund të realizojë qëllimet e Organizatës.

2. Anëtarët e personelit të OEDP-së do t'i përmbushin detyrimet e tyre si nëpunës civilë ndërkombëtarë, duke pasur parasysh parimet dhe objektivat e Organizatës. Sjellja e tyre duhet të jetë gjithmonë në përputhje me parimet e integritetit

dhe të paanshmërisë, të cilat kërkohen për punën e tyre.

3. Gjatë realizimit të detyrës së tij, personeli nuk do të kërkojë dhe nuk do të marrë udhëzime nga ndonjë qeveri apo nga ndonjë autoritet i jashtëm për OEDP-në. Ata duhet të distancohen nga çdo veprim, i cili mund të ndikojë në pozicionin e tyre si nëpunës civilë ndërkombëtarë, përgjegjës vetëm për Organizatën.

4. Bordi do të miratojë një plan kompensimi dhe përfitimi për personelin e OEDP-së. Gjithashtu, ai do të miratojë një sistem ankimi të integruar.

PJESA III

### **DISPOZITAT FINANCIARE**

Neni 14

### **Financa**

1. Organizata do t'i përfitojë burimet e saj financiare me anë të të gjitha mjeteve të saj ligjore, duke përfshirë, ndër të tjera, kontributet, kontributet vullnetare dhe donacionet, tarifën e kurseve dhe seminareve, ekzekutimin e projekteve, seminarin trajnues dhe tarifën e asistencës teknike, të ardhurat nga botimet, të gjitha llojet e të ardhurave nga shërbimet, të ardhurat e interesave nga trustet, ndihmat dhe llogaritë bankare etj.

2. Palët e kësaj marrëveshjeje nuk do të jenë përgjegjëse, individualisht ose bashkërisht, për borxhet apo detyrimet e Organizatës.

Neni 15

### **Auditimi i jashtëm**

Operacionet e Organizatës do t'i nënshtrohen një auditimi të plotë financiar, të kryer çdo vit nga kontabilistë të pavarur. Rezultatet e këtij auditimi do të jenë të disponueshme për Bordin dhe Asamblenë.

PJESA IV

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 16

### **Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi**

1. Kjo marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtete dhe organizata ndërkombëtare.

2. Kjo marrëveshje do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit.



3. Kësaj marrëveshjeje nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

4. Çdo shtet apo organizatë ndërkombëtare, e cila nuk e ka nënshkruar këtë marrëveshje, mund të aderohet në të në një kohë të mëpasshme.

5. Qeveria e Republikës Helene do të veprojë si depozitare e kësaj marrëveshjeje.

Neni 17

### Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas marrjes nga depozitari të njoftimeve nga tria palët e kësaj marrëveshjeje se formalitetet e kërkuara nga legjislacioni vendas i këtyre palëve në lidhje me këtë marrëveshje janë përmbushur.

Neni 18

### Amendimet

1. Kjo marrëveshje mund të amendohet nga Asambleja me anë të votës së shumicës me katër të pestat të të gjithë anëtarëve të saj me votë të plotë, nëse njoftimi për këtë amendim, së bashku me tekstin e tij të plotë, do t'i jenë dërguar të gjithë anëtarëve të Asamblesë, të paktën katër javë para kohës së përcaktuar për votim mbi amendimin e propozuar.

2. Amendime të tilla do të hyjnë në fuqi sapo të jetë marrë një vendim në lidhje me to.

Neni 19

### Shpërndarja

1. Organizata mund të shpërndahet nëse të gjithë anëtarët e Asamblesë me një votë të plotë vendosin në mënyrë unanime se Organizata nuk është më e nevojshme, ose se ajo nuk do të jetë më e aftë të funksionojë në mënyrë efektive.

2. Në rast shpërndarjeje, çdo aset i Organizatës që mbetet pas pagesës së detyrimeve të saj ligjore, do t'i shpërndahet institucioneve që kanë qëllime të ngjashme me ato të Organizatës, siç vendoset nga Asambleja në konsultim me Bordin.

Neni 20

### Ndërprerja

Çdo palë mund të ndërpresë aderimin e saj në këtë marrëveshje dhe të tërheqë anëtarësimin e saj nga Asambleja, duke njoftuar zyrtarisht depozitarin. Përfundimi hyn në fuqi në datën e përcaktuar në njoftim. Për sa u përket detyrimeve të ndryshme të

palës që kryen tërheqjen, një ndërprerje e tillë do të hyjë në fuqi në fund të vitit financiar në të cilin është njoftuar.

Neni 21

### Tranzicioni dhe rregulla të ndryshme

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Organizata do të përfshijë automatikisht Qendrën Europiane të së Drejtës Publike (QEDP), të themeluar më 1995-ën nën ligjin e Republikës Helene, si institucion grek me karakter ndërkombëtar dhe automatikisht do të përfitojë të drejtat, detyrimet, koncesionet, pronat, interesat e saj etj.

2. Palëve të kësaj marrëveshjeje do t'u kërkohet të pranojnë angazhimin për të mbështetur Organizatën sipas marrëveshjes së pjesëmarrjes së tyre. Palët, të cilat nuk pranojnë në marrëveshjen e pjesëmarrjes së tyre angazhimin për të mbështetur Organizatën, mund të jenë palë në këtë marrëveshje me vetëm një votë konsultative në Asamblesë e Përgjithshme, deri në momentin kur vendosin ndryshe.

Marrëveshjet e pjesëmarrjes, të përcaktuara nga shtetet ose organizatat ndërkombëtare me paraardhës QEDP-në, nëse nuk janë rishikuar, do të vazhdojnë të operojnë sipas kësaj marrëveshjeje. Ato shtete dhe organizata ndërkombëtare do të vazhdojnë të përfaqësohen në Bordin e Drejtorëve të institucionit të ri për atë periudhë të arsyeshme kohore, të nevojshme për t'u bërë anëtarë të OEDP-së sipas rregullave të kësaj marrëveshjeje.

3. Marrëdhëniet institucionale të çfarëdo lloji me palë të tjera përveç shteteve apo organizatave ndërkombëtare të përfaqësuar në Bordin e Drejtorëve të QEDP-së në kohën kur kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, nëse nuk rishikohen, do të shndërrohen në marrëdhënie bashkëpunimi të këtij instrumenti.

4. Emblema dhe flamuri i QEDP-së së mëparshme do të jetë emblema dhe flamuri i OEDP-së. Ato mund të ndryshojnë me vendim të Bordit të Drejtorëve.

5. Aktivitetet e mbuluara nga Komiteti Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve të QEDP-së së mëparshme do të mbulohen nga kjo marrëveshje deri në formimin e një Komiteti të ri Ekzekutiv dhe një bordi të ri drejtorësh.

6. Drejtori i QEDP-së së mëparshme do të vazhdojë të jetë në detyrë në kuadrin e kësaj





marrëveshjeje si drejtori i OEDP-së nën kushtet ekzistuese dhe të njëjta të punës. Këshilli Shkencor European (KSHE), presidenti i KSHE-së dhe personeli i QEDP-së së mëparshme do të vazhdojnë të operojnë si KSHE-ja, si presidenti i KSHE-së dhe si personeli në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.

7. Kudo që emërimi i një përfaqësuesi parashikohet në organet e ndryshme të OEDP-së, edhe emërimi i një pale alternative është në zgjedhjen e palës që bën propozimin.

8. Duke marrë parasysh se Grupi European i së Drejtës Publike pranë Këshillit Shkencor European ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe vendimtar në zhvillimin e QEDP-së, siç përcaktohet edhe në aktin e tij themelues në Parlament, organet e ndryshme të OEDP-së në parim do të vazhdojnë të përzgjidhen midis anëtarëve të Këshillit Shkencor European.

9. Organizata do të pranohet nga Republika Helene si e pranueshme për çdo program, projekt, punim etj., që do t'u ofrohet organizatave shtetërore greke, organizatave jofitimprurëse, organizatave joqeveritare ose organizatave me qëllim publik.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Hartuar në Athinë, më 27 tetor 2004  
Për qeverinë e Republikës së Qipros  
Për qeverinë e Estonisë  
Për qeverinë e Republikës Helene  
Për qeverinë e Republikës së Italisë  
Për qeverinë e Republikës së Moldavisë  
Për qeverinë e Serbisë  
Për qeverinë e Gjeorgjisë

Për Këshillin e Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

15.12.2010

## VENDIM Nr. 71/2014

### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 64/2013 “PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PARLAMENTARE PËR AUDITIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKE TË KLSH-SË”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, dhe të nenit 3 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të ndryshuar,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 64/2013 “Për fillimin e procedurave parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të KLSH-së”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Në pikën III, fjalët “brenda datës 17.12.2013” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 1.12.2014”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Ilir Meta

Miruar në datën 2.10. 2014

## VENDIM Nr. 72/2014

### PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 48/2013 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55, pika 1, e 21, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:



I. Deputeti Ervin Bushati caktohet anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

II. Deputetja Erjeta Alhysa caktohet anëtare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

III. Deputetet Anila Agalliu dhe Luljeta Arapi caktohen anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Ilir Meta**

Miratuar në datën 2.10.2014

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”  
Tiranë, 2014

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 20 lekë